



BASHKIA VLORE – DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE TERRITORIT

RIKONSTRUKSION I GODINËS SË KOPESHTIT NR 3 BASHKIA VLORE

RELACION PERSHKRIMI




RELACION PERSHKRIMI

Ne këtë projekt parashikohen ndërhyrje restauruese dhe rikualifikuese mbi godinën e Kopeshtit nr 3 – Bashkia Vlore

Ne vijim të kërkesës për ndërhyrje mbi godinën, grupi i punës ka zhvilluar disa vizita studimore për plotësimin e projektit.

Jane konstatuar një sërë problematikash të cilat kanë nevojë urgjente për ndërhyrje.

Ne pamjen e mëposhtme paraqitet pozicioni i godinës në lidhje me qytetin.



Ky projekt synon rikonstruksimin e godinës me riparimin e dëmeve të krijuara, forcimin e strukturës ekzistuese, rindërtimin e impianteve teknike, rishpërndarjen funksionale të brendshme si dhe ndërhyrje në hapësirën jashtë. Në mënyrë të veçantë në projekt ka një konsideratë të veçantë për kursimin energjetik dhe rritjen e cilësisë së ambienteve të brendshme nëpërmjet aplikimit të kapotit, catitës me termoizolim dhe dritaret termike.

GJENDJA AKTUALE

Nga studimi i gjendjes aktuale të objektit është vërejtur se ndërtesa është në një gjendje të pranueshme statike por paraqet mangësi të theksuara mirëmbajtjeje. Në mënyrë të veçantë vërehen dëme tek çatia, me infiltrime uji, lageshti e theksuar nga muret perimetrale, suvate, sistemi elektrik dhe hidraulik. Me poshtë jepen disa pamje nga gjendja aktuale.



NDËRHYRJET E PARASHIKUARA

Për realizimin e këtij projekti janë kryer disa vizita studimore ne objekt dhe janë studiuar strukturat ekzistuese si dhe funksionet ne to. Ne vecanti

- Nderhyrje mbi caine – Catia ekzistuese eshte ne gjendje te demtuar – paraqet infiltrime uji si dhe demtime te elementeve te kapriatave te drurit. E catia ekzistuese nuk eshte gjetur hidroizolim apo shtresa te tjetra (tavolati, termo apo bariera te tjera). Ulluqet plastik jane te demtuar dhe nje pjese e tjegullave te thyera apo mungojne. Nga nje analize kosto rezulton me leverdi zevendesimi total i catise me nje te re se sa restaurimi i saj. Nga catia e vjeter mund te shpetohen vetem nje pjese e tjegullave dhe disa elemete te kapriatave. Ne vecanti nje cati e re do te kete nje jetegjatesi me te larte se sa elementet e vjetra aktualisht ne catine e vjeter. Catia e re do te permbaje hidroizolim dhe izolim termik
- Nderhyrje mbi muret – Muret nuk paraqesin demtime strukturale te rendesishme por vetem demtime te suvase. Aktualisht catia ekzistuese mbeshtetet mbi tulla te murit perimetral, ndersa ne nderhyrje do realizohet lidhja e ekstremeve te mureve nepermjet nje rrjete brezash ne beton arme. Kjo strukture sherben edhe per lidhjen ne koke te mureve per efekte antisizmike.
- Nderhyrje mbi dyshemete – dyshemete aktuale jane me pllaka gres te demtuara vende vende dhe riparuar njolla njolla. Eshte parashikuar prishja e shtreses se pllakave dhe zevendesimi i saj me parket ne sallat qe do te perdoren si klasa– per rritjen e cilesise se ambienteve ne sherbim te femijeve. Ne hapesirat e tjera parashikohet njehesimi i pllakave te dyshemese

- Suvate – Jane hasur demtime te perqendruara te suvate por ne nje arsyetim te pergjithshem suvate jane ne gjendje te pranueshme. Eshte parashikuar vetem riparimi i zonave te demtuara si dhe ne zonat ne te cilat kalojne impiantet. Suvate do te kontrollohen me goditje me cekan gome per te percaktuar zonat e demtuara dhe riparohen me suva te re.
- Dritaret – Dritaret aktuale jane me strukture duralumin, tek xham, te ndertuara ne fund viteve 90. Kane nevojte per nje nderhyrje mirembajtje te pergjithshme por gjithsesi nuk kane aftesite termoizoluese te kerkuara ne kete projekt. Eshte parashikuar zevendesimi i tyre me dritare termike me dopio xham dhe profile duralumini termik.
- Impiantet – do te zevendesohet plotesisht impianti elektrik (ne gjendje teje te demtuar dhe jashte stadarteve te sigurise) dhe ai i furnizimit me uje.
- Impianti i klimatizimit – duke studiuar dimensionet e objektit dhe opsionet e mundshme eshte parashikuar shtimi i 4 kondicionere tip “Chiller” me nga dy dalje te cilet do te mbulojne klasat dhe hapesirat ku qendrojne femijet. Hapesirat e tjera te perbashketa (shkalle depo apo guzhina) nuk do jene te mbuluara. Kjo eshte nje zgjidhje optimale kosto – perfitimi, ku mbulimi do te jete aty ku nevojitet me teper dhe me nje kosto ndjeshmerisht me te ulet se ajo e nje sistemi qendror.
- Mbrojtja nga lageshtia i mureve perimetrale – nepermjet nje trotuari te ri, hidroizolimi deri ne temel dhe sistem kullimi.
- Mbyllja e dy ballkoneve anesore – te kerkuara nga administrata e kopeshit per hapesira shtese do te mbyllen dy ballkonet anesor ne katin e dyte nepermjet ndertimit te nje parapeti me tulla me lartesi 1 m dhe mbi e vetrate xhami me profile termike.
- Tavane e varura – eshte parashikuar eliminimi i tavanit te varur ekzistues tashme te demtuar dhe zevendeimi i tije me tava me pllaka gipsi.
- Sistemimi dhe rrethimi i hapesires – eshte parashikuar mbyllja e rrethimit ekzistues dhe sistemimi i hapesires perpara kopeshit per perdorim nga femijet.

Ne kete projekt objektivi kryesor pervec riparmeve eshte edhe nj  p rmir sim i ndjesh m i eficiences energjetike n p rmjet rritjes se termoizolimit ne elementet me influent si mbulesa dhe dyert dhe dritaret dhe ndertimi i nje sistemi klimatizimi me efica nc  shume te larte.

ORGANIZIMI I PUNIMEVE

P r punimet nd rtimore  sht  parashikuar qe materialet do te prodhohen me gur kave qe gjendet ne guroret e rrethit . Materiali i betonit do te vije i gatshem nga nyjet me te aferta ne perputhje me kerkesat e projektit.

Te gjitha punimet jane parashikuar te kryhen ne perputhje me specifikimet teknike qe i bashk ngjiten k tij projekti.

Preventivi i punimeve eshte dhene për te gjithë rrugët dhe janë parashikuar te gjithë zerat e punimeve sipas specifikimeve teknike te keti projekti, me çmimet e Manualit te Punëve Publike, per vitin 2015.

Per te gjitha zerat e punimeve jane bere analizat e prodhimit dhe vendosjes ne veper ne perputhje me organizimin e punimeve, standartet dhe kushtet teknike ne fuqi.

Bashkëngjitur këtij raporti janë dhene; specifikimet teknike te punimeve, volumet e punimeve me vleresimet e koston, dhe preventivi perkates.

Situacionimi i këtyre punimeve do te behen mbas verifikimit dhe matjes se punimit ne proces verbalin e vecante qe do te hartohet nga drejtuesi i punimeve , kontraktori dhe specialistet e Bashkisë Vlore

Grupi i Punes

Ing. Mandi Karocieri

Urb. Artan Hoshafi



Vlore 12.12.2017